



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivered	29.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Bz Prot Prot No	Shërbim Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	4506/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.716/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.716/2023 të datës 08.05.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Komunes së Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.716/2023 e datës 08.05.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja tani e pensionuar, me datë 08.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 24.04.2023 me nr. 1-120-19642 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Lipjanit. Ndërsa, Këshilli me datë 11.05.2023 ka pranuar shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4133/2023 të datës 08.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë e datës 24.04.2023 me nr.1-120-19649 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; Kërkesen EX oFF.76/2023

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nga Avokati i Popullit të Kosovës e datës 07.04.2023 me numër protokolli 650/2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Vendimin nr.1-118/02-15744 të datës 28.03.2023 me për përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit; Kërkesën për kompensimin e një page pas pensionimit të datës 19.04.2023 me nr.01-120-19649 dhe Akt emërimi i datës 13.03.2013

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedh së ankuesja ka qenë e punësuar në Komunën e Lipjanit, dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 19.03.2013 ka ushtruar pozitën e punës Nëpunës për Pranimin e Parashtrësive në Sektorin e Administratës së Përgjithshme.

Me Vendimin Nr.01-118/02-15744 të datës 28.03.2023 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 01.04.2023.

Ankuesja me datë 19.04.2023 i është drejtuar më kërkesë organit të punësimit, për pagesën e një page përcjellëse pas pensionimit, ndërsa kjo e fundit përmes Shkresës me nr. 01-120-19649 të datës 24.04.2023, ka njoftuar palën ankuese se me hyrjen në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat e Sektorit Publik me datë 05.02.2023 është shfuqizuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe rregulloret që kanë rrjedhë nga ky ligj, andaj kërkesa e ankueses nuk mund të realizohet.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 24.04.2023, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Civil, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e një page mujore përcjellëse pas pensionimit sipas nenit 19 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012. Shton se Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është i pazbatueshëm pasi që Institucioni i Avokatit të Popullit të njëjtin ligj e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

Në kuptim të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, ku me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil;.... 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.* Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave të reja ligjore Kolegji konstaton me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është shfuqizuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve si dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nëpunësve Civilë, me të cilën rregullore parashihej e drejta e një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, për nëpunësin civil i cili arrin moshën e pensionimit. Rrjedhimisht, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, pagat, shtesat dhe kompensimet tjera mund të përfitohen vetëm në pajtim me dispozita ligjore të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.



Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor si me sipër, e duke qenë së ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 29.03.2023, pra në kohën kur është i zbatueshëm Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, rrjedhë së Komuna e Lipjanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.01-118/02-15744 të datës 28.03.2023, ka zbatuar drejtë ligjin material, ngase Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të nëpunësit civil, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara ligjërisht.

Po ashtu, lidhur me pretendimin e ankueses së Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është i zbatueshëm pasi që Institucioni i Avokatit të Popullit këtë ligj e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtesues, Kolegji thekson faktin së Kuvendi i Kosovës me datë 22.12.2022 ka miratuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ligji në fjalë është shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 05.01.2023, ndërsa siç përcaktohet me nenin 46 të këtij ligji, i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 05.02.2023. Kështu që derisa pas parashtrimit të kërkesës nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk ka ndonjë vendim të Gjykatës Kushtetuese për pezullim të zbatimit të këtij ligji, i njëjti është i aplikueshëm.


Theksuar si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.716/2023

Sabile Avdyli



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

